

OPERATOR SISTEMI, TRANSMISIONI DHE TREGU SH.A.  
TRANSMISSION, SYSTEM AND MARKET OPERATOR J.S.C.  
OPERATOR SISTEMA, PRENOSA I TRŽIŠTA A.D.



## Buletini

Marrëveshje bashkëpunimi në mes të OSTShqiptar dhe KOSTT sh.a	1
Ekipet profesionale të OST Shqipëri dhe KOSTT sh.a realizojnë rehabilitimin e shtyllës në linjën interkonektive Kosovë Shqipëri	1
KOSTT përfaqësohet në Panairin mbarëkombëtar "Elita Shqiptare 2008", në Tiranë	2
KOSTT zhvillon aktivitete të rëndësishme në trajnimin e stafit të kompanisë	2
Rritet kapaciteti transmetues dhe konsumues si dhe siguria e furnizimit me energji elektrike për rajonin e Vushtrrisë, Mitrovicës, Burimit dhe Prizrenit	3
Mbahet takimi i V i Komisionit Qeverisës të Kodeve Teknike/ Operacionale-KQKO	4
Hyn në fuqi Ligji për ndërmarrjet publike	4
Mbahet Konferenca e donatorëve për Kosovën	4
Përmirësimi i Qeverisjes Korporate dhe Transparencës në Ndërmarrjet Publike në Kosovë	4
Shqipëria, në krye të Komunitetit të Energjisë	5
Turqia në rrugë për anëtarësim në Komunitetin e Energjisë	5
Programimi i Instrumentit të Paraanëtarësimin IPA 2009	5
Qeveria e Republikës së Kosovës nxjerr urdhër për shkyj dhe ri-kyeje të borschlinjeve të energjisë elektrike	6
Ministria e Ekonomisë dhe Financave nënshkruan marrëveshje financiare me KEK sh.a	6
KEK investon në ndërtimin e dy nënstacioneve	6
Vlerësimi Strategjik Mjedisor dhe Social	7
Miratohet interkoneksioni Shqipëri-Itali	7
Qeveria e Kosovës propozon anëtarësimin në Bordin e ZRRë	7
Vendimet e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRë) gjatë muajve Qershor, Korrik dhe Gusht 2008:	8
Ngjarje të ardhshme relevante në sektorin e energjisë	10

### *Marrëveshje bashkëpunimi mes Operatorit të Sistemit të Transmetimit Shqiptar dhe KOSTT sh.a*

Drejtori i Përgjithshëm i Operatorit të Sistemit të Transmetimit Shqiptar (OST) sh.a Ymer Balla dhe Drejtori menaxhues i Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të Kosovës-KOSTT sh.a, Fadil Ismajli nënshkruan memorandumin e mirëkuptimit për projektin e ndërtimit të linjës 400 kv Tiranë-Prishtinë. Qëllimi i këtij nënshkrimi është nisja sa më parë e punës, si dhe ndërmarrja e hapave për financimin, prokurimin dhe operimin e projektit, për ndërtimin e linjës së interkoneksionit midis Shqipërisë dhe Kosovës e cila do të kontribuojë në

zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të të dy vendeve. Projekti konsiston, në ndërtimin e një linje të tensionit të lartë më gjatësi rreth 238 km, prej së ciles 85 km në territorin e Kosovës, si dhe fuqizimin e nënstacioneve 400 /220 kv Tirana 2 dhe Prishtinë. Kostoja financiare llogaritet në 58 milion euro e ndarë 24 milion për pjesën e Kosovës dhe 34 milion për pjesën shqiptare. Për financimin e këtij projekti, kanë shprehur gadishmëri dhe kanë marrë angazhim qeveria gjermane nëpërmjet bankës KfW, e cila ka nënshkruar edhe memorandumin e

mirëkuptimit. Ky projekt parashikohet të fillojë brenda vitit 2009 dhe kohë zgjatja e tij është 20 muaj. Në këtë kuadër u nënshkrua edhe memorandumi i bashkëpunimit, për implementimin e projektit të rregullimit fuqi - frekuencë midis dy sistemeve elektroenergjetike.



Ymer Balla, drejtor i OST Shqipëri dhe Fadil Ismajli, drejtor menaxhues i KOSTT sh.a (nga e majta)

### *Ekipe profesionale të OST Shqipëri dhe KOSTT sh.a realizojnë rehabilitimin e shtyllës në linjën interkonektive Kosovë Shqipëri*

Me bashkëpunimin e ekipeve të mirëmbajtjes së linjave të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut-KOSTT sh.a si dhe të Operatorit të Sistemit të Transmisionit të Shqipërisë -OST, është realizuar rehabilitimi i shtyllës nr. 112 në linjën interkonektive 220 kV (kilovolt) që lidh nënstacionin Prizreni 2 me Hidrocentralin HC Fierza (Shqipëri). Për rehabilitimin

e shtyllës në fjalë, kanë punuar ekipet profesionale të dy kompanive simotra të cilat në bashkëpunim kanë siguruar edhe materialet e nevojshme si dhe makinerinë e rëndë për realizimin e remontit. Kompania e transmisionit nga Shqipëria ka ndihmuar në punët për të cilat ka të zhvilluara ekipe të specializuara. Remonti në linjën interkonektive 220 kV Kosovë-Shqipëri me

ekipe të përbashkëta në evitimin e prishjes në përgjegjësinë e njërit nga operatorëve (në këtë rast të KOSTT-it), është një nga rastet e para të bashkëpunimit konkret në punë në mes të OST Shqipëri dhe KOSTT sh.a. Shtylla e rehabilituar në fjalë paraqet nismën e bashkëpunimit në ofrimin e ndihmave të dyanshme në të ardhmen.

## *KOSTT përfaqësohet në Panairin mbarëkombëtar “Elita Shqiptare 2008”, në Tiranë*



Alb-Konfindustria, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të Shqipërisë dhe partnerët institucional të saj, në periudhën kohore 26 - 29 qershor 2008, kanë organizuar Panairin Mbarëkombëtar “Prodhimi Shqiptar 2008”, ku janë përfaqësuar industritë më të rëndësishme të

prodhimit dhe shërbimit të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi.

Në këtë panair, KOSTT sh.a u prezentua përmes një stende me sipërfaqe 12 m2 ku u prezentuan publikimet e kompanisë:

Në panair u prezentua veprimtaria e kompanisë për të cilën shprehën interes vizitorët e shumtë.

Për KOSTT ky ishte një rast shumë i përshtatshëm për realizimin e nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me kompaninë simotër në Shqipëri, ngjarje për të cilën raportuan si mediat vendore dhe të Shqipërisë po ashtu edhe ato ndërkombëtare.



*Naim Bejtullahu-zy.drejtor i KOSTT, Fadil Ismajli-drejtor menaxhues KOSTT, Bedri Hamza-zy.minister i ekonomisë dhe financave, Behxhet Halite-këshilltar i Ministrisë të MEF (nga e majta)*

## *KOSTT zhvillon aktivitete të rëndësishme në trajnimin e stafit të kompanisë*

Për realizimin e misionit, vizionit dhe strategjisë së kompanisë, Sektori për Zhvillim të Personelit dhe Trajnimeve në KOSTT, ka zhvilluar aktivitete të rëndësishme në trajnimin e stafit të kompanisë. Gjatë periudhës qershor-korrik janë realizuar disa trajnime të stafit si: Përkrahja në ngritjen e kapaciteteve profesionale për pesë punëtorët e Operatorit të Transmisionit duke iu mundësuar trajnimi për manipulim me ndërprerës të fuqisë me titull “Training 3AP1 Circuit Breakers” në kompaninë SIEMENS;

Avancimi i njohurive profesionale dhe menaxhuese duke iu mundësuar vijimin e kursit trajnues me titull “European Business Competence\*License” (EBCL ) për dy punëtorë të KOSTT;

Pjesëmarrje të përfaqësuesve në takimet e rregullta të grupeve dhe nëngrupeve punuese si “SETSO Task Force”, “ITC”, “NACMPF” si dhe në kongresin “Cigre Session 2008”. Ndërkaq që nga ky vit KOSTT ka filluar me aplikimin e një metode të re të trajnimit “On the job training”, në kuadër të së cilës

ka filluar realizimi i kursit trajnues për aplikim të metodologjisë dhe teknologjisë përmes programit kompjuterik PSS-E për inxhinierët e Sektorit për Planifikim Afatmesëm të ushtruar nga inxhinierët e sektorit për Planifikim Afatgjatë të Operatorit të Sistemit. Me qëllim të zhvillimit profesional në cilësinë e praktikantit, edhe gjatë kësaj periudhe është përcjellur implementimi i “Programit Zhvillimor” për një punëtorë nga profili i inxhinierisë dhe një nga profili i ekonomisë dhe financave.



## *Rritet kapaciteti transmetues dhe konsumues si dhe siguria e furnizimit me energji elektrike për rajonin e Vushtrrisë, Mitrovicës, Burimit dhe Prizrenit*

KOSTT sh.a në kuadër të strategjisë për zhvillimin e vazhdueshëm të Sistemit Transmetues të Energjisë Elektrike, ka përmbyllur me sukses projektin kapital për riparimin e tri linjave transmetuese 110 kV (kilovolt), linjës LP 125/1, që lidh nënstationet NS Vushtrria 2 me NS Kosova A, LP 125/4 që lidhë NS Vushtrria 2 me NS Vushtrria 1 si dhe të linjës LP 164/3 që lidhë NS Prizreni 1 me NS Prizreni 2. KOSTT sh.a, pas riparimit, ka kthyer nën tension edhe linjën e tensionit të lartë 110 kV (kilovolt) LP 125/1 e cila

lidhë Nënstationin NS Vushtrria 2 me Nënstationin NS Kosova A, deri sa linjat LP 125/4 dhe LP 164/3 janë kthyer nën tension paraprakisht. Vlera e projektit në fjalë është 1.188.297.30 EUR dhe është financuar nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, ndërkaq punët i ka implementuar kontraktuesi UMEL Dalekovodmontaza nga Tuzla (BH). Projekti në fjalë me angazhimin e stafit të KOSTT-it si dhe të vet kontraktorit ka përfunduar 2(dy) javë para afatit kontraktues. Me investimin kapital për riparimin e

linjave në fjalë, do të rritet siguria e furnizimit me energji elektrike si dhe kapaciteti transmetues dhe konsumues për rajonin e Vushtrrisë, Mitrovicës, Burimit dhe Prizrenit. Këto linja deri më tani kanë qenë “fyte të ngushta” në rrjetin e transmisionit të energjisë elektrike. Operatori i Sistemit Transmisionit dhe Tregut-KOSTT sh.a falenderon Institucionet e Kosovës për financimin e projektit në fjalë dhe njëherit falenderon qytetarët për mirëkuptimin e tyre gjatë kohës sa ka zgjatur riparimi i linjave.



## *Mbahet takimi i V i Komisionit Qeverisës të Kodeve Teknike/ Operacionale-KQKO*

Takimi i pestë me radhë i Komisionit Qeverisës të Kodeve Teknike/Operacionale-KQKO, u mbajt me 7 gusht 2008. Gjatë takimit u diskutuan çështjet e parapara me agjendë si dhe u morën disa vendime: Grupi i përcaktuar punues të bëjë një analizë të gjendjes ekzistuese dhe të japin vlerësimin mbi aplikimin e mbrojtjes sistemore; Grupi Punues i përcaktuar në kohë sa më shkurtër të përgatis një raport mbi ndërrimin e parametrave në nenin 3.2 të Kodit të Pajisjeve Elektrike dhe të thirrret një takim shtesë i KQKO-së për të shqyrtuar

për aprovim propozimin.; Duke u bazuar në Procedurat për operimin e KQKO-së, secili anëtarë i komisionit ka emëruar nga një alternativ/zëvendësues; U miratua Logo e KQKO-së përdorimi i së cilës hyn në fuqi nga minutat e takimit të V-të të KQKO-së. Të gjitha dokumentet që dalin nga ky komision duhet të përmbajnë Logon identifikuese. KQKO është një trup i krijuar në bazë të procedurave të dala nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Objektivat e KQKO-së janë: të shqyrtoj dhe diskutoj Kodin e Rrjetit, Distribucionit, Matjes, si dhe zbatueshmërinë e tyre; Kodet

e Standardeve dhe Pajisjeve të Energjisë Elektrike; Kodin për Mbrojtjen e Konsumatorëve; shqyrton dhe diskuton sugjerimet për ndryshime; diskuton çfarë modifikime janë të nevojshme dhe publikon rekomandimet e saja. KQKO përbëhet nga 8 anëtarë të cilët përfaqësojnë Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Tregut-KOSTT, Distribucionin – KEK, Gjenerimin-KEK, Furnizuesin publik-KEK, ZRrE-në, Gjeneruesit e pavarur, Furnizuesit/tregtuesit e pavarur dhe konsumatorët e kualifikuar

**LIGJI NR. 03/L-087***Hyn në fuqi Ligji për ndërmarrjet publike*

Me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me 15 qershor, hyri në fuqi edhe Ligji për ndërmarrjet publike i cili u miratua nga Kuvendi i Kosovës dhe u nënshkrua nga presidenti Fatmir

Sejdiu. Sipas këtij Ligji, çdo ndërmarrje publike do të ketë nga 5 anëtarë të Bordit, ndërkaq, në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave do të krijohet njesia për monitorimin e

ndërmarrjeve publike si dhe një komitet i përbërë nga 5 ministra dhe i cili do të vendosë për politikën afatgjatë të Ndërmarrjeve Publike Qendrore-NPQ.

*Mbahet Konferenca e donatorëve për Kosovën*

Ashtu siç edhe është planifikuar, me 11 korrik, në Bruksel u mbajt Konferenca e Donatorëve për Kosovën. Në këtë konferencë, Qeveria e Kosovës ka mbledhur një shumë të konsiderueshme të mjeteve për financimin e projekteve zhvillimore shumë e cila është vlerësuar se i ka arritur parashikimet e Qeverisë së Kosovës. Nga kjo konferencë, Kosova përfitoi 1.2 miliard

euro, ku donatori më i madh ishte Komisioni Evropian, me 500 milion euro, SHBA 400 milion, Gjermania 100 milion, Britania e Madhe dhe Norvegjia me nga 30 milion, Luksemburgu 15 milion etj. Projektet e KOSTT të prezantuara në Konferencën e Donatorëve përmes Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve janë: SCADA/EMS-13M Euro,

Rehabilitimi i TS 220/110 kV – Kosova A - 1.4M Euro, Paket Projekti TS 400/110 kV – Ferizaj 2-15.8M Euro, Instalimi i TR3/TR1 150 MVA, TS 220/110 kV - Prishtina-3M Euro, Instalimi i TR3/TR1 150 MVA, TS 220/110 kV - Kosova A- 3M Euro, Instalimi i TR3/TR1 150 MVA, TS 220/110 kV - Prizreni 2 - 3M Euro. Ndërrimi i përçuesve në Linjat 110 kV-5.8 MEuro

*Përmirësimi i Qeverisjes Korporative dhe Transparencës në Ndërmarrjet Publike në Kosovë*

**“Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut-KOSTT sh.a është ndërmarrja e vetme publike në vend e cila ka publikuar Raportet e Auditorit”, studimi i RIINVEST**

Instituti për hulumtime “Rinvest”, në muajin korrik, ka bërë publik studimin “Përmirësimi i Qeverisjes Korporative dhe Transparencës në Ndërmarrjet Publike në Kosovë” në të cilin përveç ndërmarrjeve të tjera publike është studiuar edhe KOSTT. Theksi i këtij studimi është vënë në

raportet financiare në ndërmarrjeve publike të vendit, si pasqyrë më e mirë se si funksionon një ndërmarrje brenda një periudhe të caktuar. Në studimin e RIINVEST, theksohet se nga të gjitha Ndërmarrjet Publike në Kosovë, Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut-KOSTT sh.a është

ndërmarrja e vetme publike në vend e cila ka publikuar Raportet e Auditorit.

KOSTT sh.a, që nga themelimi i saj në vitin 2006, praktikon publikimin në faqen e saj elektronike të raporteve të auditorit të pavarur për secilin vit. (mediat vendore)

## Shqipëria, në krye të Komunitetit të Energjisë

Që nga Qershori i këtij viti, Republika e Shqipërisë ka marrë presidencën e radhës në Komunitetin e Energjisë e cila zgjatë gjashtë muaj. Gjatë Presidencës së Republikës së Shqipërisë, gjatë vjeshtës do të zhvillohen në Tiranë dy

aktivitete të rëndësishme për Komunitetin e Energjisë nga Sekretariati i Energjisë në Vjenë. Bëhet fjale për Forumin Social dhe punëtorinë për konkurrencën në tregun energjetik rajonal. (alsat)



Vendet anëtare në Komunitetin e Energjisë

## Turqia në rrugë për anëtarësim në Komunitetin e Energjisë

Me 15 korrik të vitit 2008, Këshilli i Bashkimit Evropian u pajtua që të zgjeroj Komunitetin e Energjisë duke përfshirë Turqinë, e po ashtu edhe Moldovën dhe Ukrainën. Këshilli, ka adoptuar direktivat të cilat do ti mundësojnë Komisionit Evropian, që të negocioj

aranzhimet për pranimin e këtyre vendeve në Komunitetin e Energjisë. Komuniteti i Energjisë, i cili është në fuqi që nga korriku i vitit 2006, e shtrinë tregun e brendshëm të energjisë tek palët kontraktuese nga Evropa Juglindore dhe më gjerë. Qëllimi është që të

sigurohet një ambient stabil i investimeve, duke u bazuar në sundimin e ligjit. Po ashtu, palët kontraktuese i lidhë me Bashkimin Evropian si dhe kontribuon në sigurimin e furnizimit me energji më gjerë në Evropë. (Enlargement Nwesletter, Gusht 2008)



## Programimi i Instrumentit të Paraanëtarësimi IPA 2009

Me iniciativën e MEM është mbajtur takimi i parë për fillimin e programimit të Instrumentit të Paraanëtarësimi për vitin 2009, takim i cili u kryesua nga Zv. Ministri Blerim Rexha. Në këtë takim, u formua grupi Punues i cili do të kryesohet nga MEM dhe ku do të jenë të përfshirë akterët e sektorit të energjisë dhe të minierave.

Ky grup punues do të bëjë definimin e projekteve që do ti prezantohen Komisionit Evropian. Programi i Instrumentit të Paraanëtarësimi IPA 2009 për Kosovën, kap vlerën prej 106.1 milion Euro, ndërkaq projektet për tu kualifikuar për këtë program duhet që të reflektojnë pritoretet e qeverisë së Kosovës si dhe

të Bashkimit Evropian. Konceptet e projekteve që do të përfshihen në IPA 2009 do të zgjedhen nga Komisioni evropian në konsultim me Agjensionin për Integritet Evropian. Përgatitja e koncepteve të projekteve është paraparë që të përfundojë në muajin Shtator.

IPA është ndihmë financiare e Bashkimit Evropian për vendet kandidate për anëtarësim si dhe vendet potenciale për kandidim, me qëllim që ti ndihmojë ato për të ndërmarrë reformat e duhura politike, ekonomike dhe institucionale në përputhje me standardet e BE-së

## *Qeveria e Republikës së Kosovës nxjerr urdhër për shkyçje dhe rikyçje të borxhlinjve të energjisë elektrike*




Korporata Energjetike e Kosovës, në muajin gusht ka filluar me zbatimin e urdhërit të Qeverisë së Republikës së Kosovës 6/29, për shkyçje dhe rikyçje të borxhlinjve të energjisë elektrike. “Qëllimi i këtij urdhri është që të vendosë kushte dhe procedura të përkohshme për shkyçje dhe rikyçje në rrjetin e furnizimit me energji elektrike ndaj

konsumatorëve abuzues dhe borxhlinjve”. Të përkrahur nga Ministria e Energjisë dhe Minierave dhe personalisht nga ministria Justina Pula-Shiroka dhe zv/ministri dr. Blerim Rexha, KEK ka filluar me procesin e shkyçjeve të borxhlinjve komercial. Ministria Shiroka-Pula, me rastin e ekzekutimit të shkyçjeve ka theksuar “Monitorimi nga

ana e Ministrisë së Energjisë dhe Minierave (MEM), bëhet me qëllim të dhënies përkrahje Urdhrit nga Qeveria si dhe zbatimin në tersi të tij. Ky proces pritet të zgjas gjashtë muaj. Nga fillimi i implementimit të urdhërit për shkyçje të konsumatorëve borxhlinj, inkasimi është rritur mbi 15 % krahasuar me javën e parë të muajit gusht. (lajm)

## *Ministria e Ekonomisë dhe Financave nënshkruan marrëveshje financiare me KEK sh.a*



Me 24 qershor 2008 u zhvillua ceremonia e nënshkrimit të marrëveshjeve financiare midis Qeverisë së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave z. Ahmet Shala dhe Korporatës Elektroenergjetike të Kosovës (KEK). Marrëveshjet financiare

arrijnë shumën 84.4 milionë Euro. Kredia e parë në vlerë prej 9.4 milion Euro do të përdoret për përfundimin e riparimit të Bllokut A5 në TC Kosova A. Ndërsa kredia e dytë në vlerë prej 75 milionë Euro do të përdoret për blerjen e ekskavatorëve të rinj dhe riparimin e disa sistemeve

ekzistuese të nevojshme për vazhdimin e shfrytëzimit të mihjeve ekzistuese dhe hapjen me kohë të mihjes së re të linjtit në Sibovcin Jugperëndimor. Ky investim do të siguroj furnizim të qëndrueshëm me linjit i termocentraleve edhe pas vitit 2010. (mediat vendore)

## *Korporata Energjetike e Kosovës investon në ndërtimin e dy nënstacioneve*

Përfaqësuesit e Korporatës Energjetike të Kosovës me 20 gusht, kanë nënshkruar me kryetarin e komunës së Vitisë, z. Nexhmedin Arifi, marrëveshjen për ndërtimin e dy nënstacioneve të reja 10/04 kV me kapacitet prej 250 kVA. Vlera e këtij projekti është 40 000 euro,

prej së cilës 80% do të investojë KEK ndërsa 20% do të investojë Kuvendi Komunal i Vitisë. Me investimin në ndërtimin e këtyre dy nënstacioneve do të mundësohet furnizimi më i mirë dhe më i rregullt i me energji elektrike për banorët e këtij rajoni. Ky

projekt pason pas investimeve që KEK ka bërë një muaj më parë me investimin në dy largpërçues në fshatrat Binçë dhe Sllatinë në vlerë prej 160 mijë euro sikurse dhe nënstacionet e reja në Pozharan dhe Verban, në vlerë prej 45 mijë euro.

## *Vlerësimi Strategjik Mjedisor dhe Social*

Me 26 qershor, Ministria e Energjisë dhe Minierave ka bere publik draft dokumentin "Vlerësimi Strategjik Mjedisor dhe Social", raport i cili do te dalë në opinion për debat në mënyrë që të merren

vërejtjet dhe sugjerimet mjedisore për ndërtimin e Termocentralit Kosova C. Ministria e Energjisë dhe Minierave dhe Projekti i Asistencës Teknike Energjia nga Linjiti, me 11 shtator organizojnë Dëgjim

Publik me temën: Vlerësimi Strategjik Mjedisor dhe Social i projektit Kosova C. Dëgjimi publik mbahet në Shtëpinë e Kulturës në Kastriot me fillim në ora 10:00.



*Mabir Jagçular-ministër I Ambientit dhe Planifikimit Hapsinor, Justina Shqiroka-Pula-Ministre e Energjisë dhe Minierave, Ranjit Nayak-Banka Botërore*

## *Miratohet interkoneksioni Shqipëri-Itali*

Me 18 gusht 2008, Ministria e Zhvillimit Ekonomik e Italisë, ka firmosur autorizimin ndër të tjera edhe ndërtimin e linjës interkonektive që do të lidhë qytetin r Brindizit me nënstacionin e Vlorës. Linja interkonektive me Shqipërinë në gjatësi prej 155 km nën det në

kanalin e Otrantos do të jetë i aftë për të transmetuar 500 MW energji. Kjo linjë parashihet që të dërgojë në Itali energjinë e prodhuar nga centralet eolike që janë planifikuar të ndërtohen në Karaburun dhe në Llogara. Projekti do të kushtojë 190 milion Euro, ndërkaq nga

Qeveria Shqiptare është miratuar në janar të këtij viti. Sipas Entit Rregullator të Energjisë në Shqipëri, linjat tregtare të ndërtuara nga privatët duhet të vënë në dispozicion të OST-së 20 % të kapacitetit, ndërkaq pas 20 vjetësh kalojnë në pronësi publike. *(Lajm)*

## *Qeveria e Kosovës propozon anëtarët e rinjë në Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë*

Qeveria e Republikës së Kosovës, në takimin e mbajtur me 27 gusht 2008, ka propozuar emrat e dy anëtarëve të rinjë për anëtarë të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të

Energjisë. Pas propozimi të Qeverisë, të propozuarit Petrit Kabashi dhe Blerim Koci pritet që të emërohen nga Kuvendi i Kosovës, ndërkaq propozimi për

anëtarin e tretë të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë do të bëhet më vonë. *(Koha Ditore)*

## Vendimet e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRrE) gjatë muajve Qershor, Korrik dhe Gusht 2008:

- Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka aprovuar Kodin e Punës për Qasje në Tokë dhe Ndërtesa të KOSTT sh.a (D\_088\_2008)
- ZRRrE ka aprovuar kërkesën e KOSTT që të obligojë TGC Inc. që të paguajë detyrimet që dalin nga Rregullat e Tregut dhe nga Marrëveshja Kornizë për Implementimin e Rregullave të Tregut e nënshkruar nga të licencuarit (D\_092\_2008)
- Aprovohen Standardet e Sigurisë së Sistemit të Transmisionit dhe Planifikimit të KOSTT sh.a (D\_106\_2008)
- ZRRrE ka shqyrtuar kërkesën e KOSTT dhe pas vlerësimit të biografisë së kandidatit ka aprovuar kërkesën që Z. Ali Gashi të jetë ekspert i pavarur i cili në bazë vjetore do të kryejë kontrollin teknik dhe të sigurisë së Sistemit të Transmisionit.(D\_089\_2008)
- Aprovohen Standardet e Sigurisë së Operimit të Operatorit të Sistemit të Transmisionit të KOSTT sh.a (D\_105\_2008)
- I lejohet KOSTT SH.A. derogimi në zbatimin e dispozitave të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit . (D\_104\_2008)
- Në bazë të kërkesës së parashtruar nga KOSTT, ZRRrE ka lejuar derogimin në zbatimin e Nenit 24 “Obligimi i Sigurimit” të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit (D\_114\_2008)

Dispozitat e derroguara nga Licenca e Operatorit të Sistemit të Transmisionit

Nr.	LICENCA	Neni	Paragrafi	Periudha e Derogimit (në vite)	Arsyeja e kërkesës
1.	Operatorit të Sistemit të Transmisionit	5. Operimi i Sistemit të Transmisionit	5.3	6 muaj	Duhet të përgatitet “Metodologjia e kyçjes së shfytëzuesve në sistemin e transmisionit” në bazë të Rregullit mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me EE, e që na duhet përkrahje e konsulentëve për këtë.
			5.5		
			5.7		
		9. Disponueshmëria dhe Mirëmbajtja e të Dhënave	9.4	6 muaj	Mirëmbajtja e të dhënave të informacioneve për kapacitetet kufitare bëhet por publikimi nuk bëhet për shkak të rrethanave të ndryshme. Poashtu nuk disponojmë me harduerin dhe softuerin e nevojshëm për kalkulimin e ngarkesës së rrjedhjes dhe menaxhimin e kongjestionit të cilat momentalisht bëhen me PSSE por nuk janë valide pa këmbimin e modeleve të TSO-ve fqinje e kjo është si pasojë e mospjesëmarrjes së KOSTT në Mekanizmat sikurse ITC/CBT, Menaxhimin e Kongjestionit etj.
		11. Operimi i Sistemit	11.1	6 muaj	Për shkak të mosfunksionimit të plotë të Rregullave të Tregut nuk mund të realizohet komplet.
			11.2		
12. Blerja Ekonomike e Aseteve, Shërbimeve dhe Shërbimeve Ndhimëse	12.1	2(dy) vjet	Rregullimi terciar nuk mund të sigurohet sipas kushteve të parapara me Kodin e Rrjetit si dhe në tarifa nuk mund të mbulohet.		
	12.2				



- Aprovohen tarifat e transmisionit për t'u aplikuar nga KOSTT sh.a, duke filluar nga 1 qershori 2008.

Tabela: Tarifat e ngarkesës për KOSTT-SH.A që do të zbatohen nga data 1 qershor 2008

Grupi tarifor	Niveli i tensionit të lidhjes	Elementet tarifore	Njësia	E aprovuar vitin 2008
Gjenerimi	400kV / 220kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/MW/vit	0.000
		Tarifat për operim të sistemit	€/MWh	0.853
		Tarifat për operim të tregut	€/MWh	0.013
Gjenerimi	110kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/MW/vit	0.000
		Tarifat për operim të sistemit	€/MWh	0.853
		Tarifat për operim të tregut	€/MWh	0.013
Gjenerimi	Distribucioni	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/MW/vit	0.000
		Tarifat për operim të sistemit	€/MWh	0.289
		Tarifat për operim të tregut	€/MWh	0.013
Furnizimi	400kV / 220kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/MW/vit	3.618
		Tarifat për operim të sistemit	€/MWh	0.853
		Tarifat për operim të tregut	€/MWh	0.013
Furnizimi	110kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/MW/vit	7.878
		Tarifat për operim të sistemit	€/MWh	0.853
		Tarifat për operim të tregut	€/MWh	0.013

- I lejohe KOSTT sh.a derogimi në zbatimin e dispozitave të nenëve të Kodit të Rrjetit dhe Kodit të Matjes si më poshtë (D\_107\_2008):

Dispozitat e derroguara nga Kodi i Rrjetit

Nr.	Pjesa e Kodit	Neni	Paragrafi	Periudha e Derogimit (në vite)	Arsyeja e kërkesës
1.	Kodi Operativ	5.5.3 Stabiliteti dhe Mbingarkesa e Rrjetit	5.5.3.3	6 muaj	Mungojnë studimet rutinore mbi sigurinë, priten paisjet PSSE/EMS
2.	Kodi i Balancit	3.9 Programi i Tensionit	3.9.1.1	6 muaj	Me qëllim të nxjerrjes së programit të tensionit janë kërkuar licencat për PSSE me anë të cilit do të bëhen analizat përkatëse.
			3.9.1.2		
			3.9.1.3		
			3.9.1.4		
3.	Kodi i Planifikimit Operativ	3.4.3 Pengesat e Sistemit të Transmisionit	3.4.3.1	6 muaj	Vlerësimi i Sigurisë së Sistemit nuk është i mundshëm për planifikimin afatmesëm dhe afatshkurtë
			3.12 Vlerësimet e Sigurisë së Sistemit Energjetik	3.12.1	6 muaj
		3.12.2			
		3.12.4			

Dispozitat e derroguara nga Kodi i Matjes

Nr.	Kodi	Neni	Paragrafi	Periudha e Derogimit në vite	Arsyeja e kërkesës
		8.2 Matjet e Kapacitetit (Fuqisë) dhe Energjisë	8.2.2.8	6 muaj	Në TS. Ferizaj akoma bërthama për matje shërben njëkohësisht edhe për mbrojtje.

- Në bazë të kërkesës së parashtruar nga KOSTT, ZRrE ka lejuar derogimin në zbatimin e Nenit 24 "Obligimi i Sigurimit" të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit (D\_114\_2008)
- ZRrE jep pëlqimin për Bilancin Afatgjatë 2009-2018

## Dokumentet në proces të aprovimit nga ZRRE

- Plani Zhvillimor dhe Investiv i Transmisionit TNDP
- Plani për Mjaftueshmërinë e Gjenerimit (GAP) (është dërguar në ZRrE, pritet dhënia e pajtueshmërisë)
- Metodologjia e Tarifave per Kyçje
- Kodi i Shpërndarjes
- Kodi i Matjes së OSSH-se

**Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut-KOSTT sh.a** - është kompani publike e cila merret me planifikimin, zhvillimin, mirëmbajtjen dhe operimin e sistemit të transmisionit të energjisë elektrike në Kosovë. KOSTT është përgjegjës për transmisionin e energjisë elektrike të tensionit të lartë 400 kV, 220 kV dhe 110 kV dhe po ashtu është përgjegjës për organizimin dhe administrimin e tregutit të energjisë elektrike.

## MISIONI

Të siguroj:

- shërbime cilësore duke implementuar të arritura tekniko-teknologjike në zhvillimin e sistemit të transmisionit;
- transparencë dhe jo-diskriminim në tregun konkurrues të energjisë elektrike;
- avancim të pozitës në nivelin rajonal dhe evropian përkrahur nga ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve njerëzore.

## VISIONI

Të jetë kompani profitabile, për transmetimin e sigurt dhe stabil të energjisë elektrike, e përgjegjës ndaj shoqërisë dhe mjedisit, e integruar në mekanizmat evropian.

---

## Ngjarje të ardhshme relevante në sektorin e energjisë

*7 Tetor 2008  
Prishtinë, Kosovë*

• **Konferencë për investime**, Organizuar nga: Sekretariati i Komunitetit të Energjisë  
Website: [www.energy-community.org](http://www.energy-community.org)

*6-7 Nëntor 2008  
Portorož, Sloveni*

• **Konferencë për investime**: Mundësitë e investimeve në Sektorin e Energjisë në Ballkanin Perëndimor  
Website: [www.investment-conference.si](http://www.investment-conference.si)

*10-14 Nëntor 2008  
Athinë, Greqi*

• **Java e energjisë 2**, Organizuar nga IENE  
Website: [www.iene.gr](http://www.iene.gr)

---

• **Buletini** është publikim i Sektorit për Komunikim, DQLR të KOSTT sh.a  
Rr. Iljaz Kodrap.n, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381(0) 38 501 6011 74 ; email: [info@kostt.com](mailto:info@kostt.com)  
Web: [www.kostt.com](http://www.kostt.com)  
Përgatitur nga: Zana Bajrami-Rama